

BASHKIA GRAMSH
NJOFTIM FITUESI PËR DHËNIE ME QIRA

Për : Shoqërinë “ONE SOLAR” sh.p.k me adresë : Rruga “Komuna e Parisit”,nr.pasurie 6/284-N14, Zona Kadastrale 8260,Njësia Administrative nr.5, 1019, Tiranë .

Procedura e konkurimit: Procedurë e Hapur, me objekt “Për dhënien me qira të fondit pyjor në ngastrat/nëngastrat pyjore nr.1/e, 2/b,dhe 23/d të ekonomisë pyjore “Galigat-Storë”,Zona Kadastrale 1556, 3262 dhe 1736”:

Çmimi dysheme për fillimin e konkurimit : 1 716 000 (një milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë)lekë/vit.

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: Bashkia Gramsh do të japë me qira fondin pyjor/kullosor të ndodhur në zonat Kadastrale 1556, 3262 dhe 1736”, ngastrat/nëngastrat pyjore nr.1/e, 2/b,dhe 23/d të ekonomisë pyjore “Galigat-Storë, me sipërfaqe 12 ha.

Qëllimi i dhënies me qira të kësaj sipërfaqe është “Për vendosje stacionesh , bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë” si dhe sigurimi i të ardhurave për bashkinë Gramsh .

Kohëzgjatja e kontratës: Afati i dhënies me qira do të jetë 10 vjet nga data e lidhjes së kontratës .

Publikime të mëparshme: Buletini i Prokurimit Publik nr.70 date 21.10.2024

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- Shoqëria “ONE SOLAR” sh.p.k me NIPT nr. M41505052R, me vlerë totale të ofertës 1 752 000(një milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë/vit,pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtem:

- Nuk ka ofertues të skualifikuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:Shoqërinë “ONE SOLAR” sh.p.k me adresë : Rruga “Komuna e Parisit”,nr.pasurie 6/284-N14, Zona Kadastrale 8260,Njësia Administrative nr.5, 1019, Tiranë, se oferta e paraqitur, me vlerë 1 752 000(një milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë/vit,pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Gramsh, komisionit të konkurimit, kati i dytë i godinës së bashkisë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e konkurimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [.....], siç parashikohet në legjislacionin në fuqi për ankandet.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.11.2024

Ankesa: Nuk ka patur ankesa